



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

**OPINION MBI KANDIDATIN Znj. ELONA ALVORA**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 18.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Elona Alvora, e cila është e caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurorja Elona Alvora ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2009, pasi me dekretin nr. 6749, datë 12.10.2009 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në stazh në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga dosja personale rezulton se është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe nuk ka patur transferime te tjera. Znj. Alvora ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 10 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.1959 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë rezulton se për shkak ngarkese në këtë Prokurori, vetëm një prej tre kandidaturave të ardhura nga kjo Prokurori, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Vlorës, por pa specifikuar një emër konkret.

Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se, në kushtet kur janë tre kandidatura nga e njëjta prokurori dhe nga ana e Drejtuesit nuk është përcaktuar një emër konkret, në raportin mes kandidaturave, njëri kandidat ka eksperiencë të mëparshme si Këshilltar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe nuk ka dosje penale në administrim në Prokurorinë e Vlorës. Për këtë arsye Komisioni mendon se komandimi i Znj.Alvora do të cënonte mbarëvajtjen e punës dhe interesin më të lartë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

*Përfundimisht nga kandidimi për komandim të prokurorit Elona Alvora, për shkak se komandimi i tij do të ndikonte veprimtarinë normale të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*

## **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

Datë: 24.02.2020